



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.962/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS –Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit I..., te cilën e përfaqëson me autorizim Kujtesa Nezaj-Shehu kundër të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Komisioni për shqyrtimin e Ankesave e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1135/17 të datës 14.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.03.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Komisioni për shqyrtimin e Ankesave, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, A.nr.1135/17 të datës 14.01.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, A.nr.1135/17 të datës 14.01.2021, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit I..., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës. Anulohet vendimi i te paditure Agjencisë për pronësi Industriale i dt. 26.09.2014, vendimet e shkallës së dytë Komisionit për shqyrtimin e Ankesave –Agjencia e Pronësisë Industriale(ZPI-API) me nr. 4/2017 i dt. 06.06.2017 dhe Nr. 6/2017 i dt. 12.07.2017. Detyrohet Agjencia e Pronësisë Industriale që paditësit t’ia lejoj regjistrimin e markës “S...” për te cilin ka aplikuar ne baze te aplikacionit me nr. 3454 dt. 15.10.2008 këtë ne afat 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura për shkak të: shkeljes së dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj ankesën e paditësit, ta ndryshoj Aktgjykimi e goditur ose te njëjtin te kthej ne rigjykim.

Paditësja ne përgjigje ne ankese i ka propozuar gjykate qe ankesën e te paditurës te refuzoj si te pabazuar dhe te vërtetohet aktgjykimit te ankimuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën

Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, me vendimin nr. 61/2014 dt. 19.01.2014 ishte refuzuar ankesa e paditësit si e pabazuar, ka refuzuar ankesën e paditësit, dhe ka lënë në fuqi aktvendimin te dt.26.09.2014. kundër këtij vendimi paditësi kishte inicuar padi ne Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, e cila me aktgjykimin nr. 2580/2014 dt. 15.02.2017 ishte aprovuar ankesa e paditësit dhe ishte anuluar vendimi i te paditurës nr. 61/2014 dhe çështja ishte kthyer ne rishqyrtim dhe rivendosje. Me aktvendimin e te paditurës 4/2017 dhe vendimin e mëvonshëm nr. 06/2017 i ishte aprovuar ankesa e paditësit për arsye, te kalkulimit te gabuar te afatit për dorëzim te dokumentacionit dhe taksen e depozitës. Paditësja përsëri ka parashtruar padi ne gjykate duke kërkuar aprovimin e padisë se paditëses dhe anulimin vendimeve te lartecur te paditurës, me arsyetimin se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa drejtë dhe i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 14.01.2021, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë duke u bazuar në provat siç janë: aktvendimet kontestuese të paditurës, aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare nr. 9658 i dt. 15.10.2008, njoftimi për plotësimin e elementeve formale te kërkesës, njoftimi për vonës te detyrimit te fletëpagesave, lista e fletëpagesave, kërkesën për plotësim te aplikacionit dëshminë e pagesës se lëshuar nga R... si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, andaj, duke u bazuar në provat e cekura më lartë gjykata e shkallës së parë, vendosi që ta aprovoj padinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë referohet ne nenin 132 parag.4 të Ligjit 05/L-031 te LPA i cila dispozite parasheh se “Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala”.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, këtë qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, konsideron se aktgjykimin ankimuar ka mbështetje ligjore dhe faktike. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka dhënë konstatimet faktike lidhur me parregullsitë ligjore dhe faktike.

Sa i përket pretendimeve ankimore se janë bërë shkelje të dispozitave të nenit 63 të LKA-së, lidhur me nenin 182 pika (n) të LPK-së, pasi gjykata e shkallës së parë, gjatë procedurës nuk i ka zbatuar drejt dispozitat e ligjit, Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe të

argumentuara në provat e lëndës dhe në dispozitat ligjore në fuqi, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Nuk është kontestuese se vete e paditura me aktvendimin nr. 4/2017 dhe vendimin e mëvonshëm nr. 06/2017 i ishte aprovuar ankesa e paditësit për arsye, te kalkulimit te gabuar te afatit për dorëzim te dokumentacionit dhe taksen e depozitës, te cilat fakte i ka vërtetuar e gjykata e shkallës se pare kur ka aprovuar padinë e paditësit te cilat janë vendimtare për rastin konkret.

Gjykata nuk ka mundur ti marr parasysh pretendimet ankuesit, pasi qe sipas konstatimeve te lartecekuar pretendimet e paditurës janë tërësisht të pa qëndrueshëm dhe të pa mbështetur në prova materiale, njashtu janë shumë kontradiktor në vetvete dhe në raport me provat e administruara, si dhe me bazën ligjore në fuqi, sepse ankuesi nuk ka qenë të gjendje të provojë përmes ndonjë dëshmie me të cilin do të argumentohet te kundërtën e konstatimeve te dhëna ne arsyetimin e aktgjykimin e atakuar.

Gjithashtu Kolegji, konsideron se gjykata e shkallës së parë, ka zbatuar drejt ligjin kur ka nxjerr konstatimin se paditësi ka rënë ndesh me dispozitat ligjore nga neni 132 parag 4 të nenin 132 parag.4 të Ligjit 05/L-031 te LPA i cila dispozite parasheh se “Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulohet apo ndryshohet, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala”. Paditësi edhe ne procedurën administrative të ankesave pranë organit administrativ dhe para gjykatës së shkallës së parë, ka dëshmuar prova me te cilat vërtetohen se pretendimet e tij e që gjejnë mbështetje faktike dhe ligjore, prandaj pretendimet ankimore nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, thënie e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të atakuar, Kolegji, konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësorë të dispozitave ligjore, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.962/22 datë 06.03.2023

Kryetar i Kolegjit,
Ramush Bardiqi